

Përshëndetje,

Në cilësinë e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ju përcjell përgjigjen zyrtare në lidhje me kërkesën tuaj për informacion:

1. Sa vaksina HPV janë kryer në gjysmën e parë të vitit 2025 (Janar–Qershor)?

Në total, gjatë periudhës janar–qershor 2025 janë aplikuar 5,498 vaksina ndaj HPV.

2. Sa vajza janë vaksinuar dhe të cilës grupmoshe?

Sipas Kalendarit Kombëtar të Vaksinimit, vaksina ndaj HPV aplikohet te vajzat 13 vjeç (një dozë). Paralelisht, në kuadër të Fushatës shtesë të vaksinimit, është përfshirë edhe grupmosha 14–20 vjeç me një dozë vaksine.

Gjatë periudhës janar–qershor 2025 janë vaksinuar:

- 2,868 vajza të lindura në vitin 2012 (mosha 13 vjeç)
- 2,630 vajza të grupmoshës 14–20 vjeç

3. A janë kryer vaksinime në të gjithë qarqet? Nëse jo, në cilët qarqe janë kryer vaksinimet?

Vaksinimi ndaj HPV realizohet në të gjithë vendin. Çdo vajzë 13 vjeç, pavarësisht vendbanimit, ka akses për t'u vaksinuar.

4. A janë porositur vaksina për vitin 2026 ose pritet të porositen?

Procesi i porosisë së vaksinave për vitin 2026 është aktualisht në zhvillim.

5. Nëse po, cilat janë pritshmëritë për vitin 2026?

Synohet rritja e mbulueshmërisë vaksinale.

6. A janë kryer fushata informuese në shkolla apo qendra arsimore për ndërgjegjësimin mbi vaksinën HPV?

Instituti i Shëndetit Publik, në bashkëpunim me strukturat e shëndetit publik vendor, ka realizuar fushata sensibilizuese në shkolla dhe qendra arsimore për rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e vaksinës HPV, si në shkollat “Petro

Nini Luarasi”, “Sami Frashëri”, “Emin Duraku”, si dhe në Sheshin Italia. Gjithashtu ISHP kryen promovim dhe në rrjete sociale.

7. A pritët përfshirja e djemve në fushatat e vaksinimit?

Është në proces vlerësimi.

Faleminderit,

Xhuljana